



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

DORACAK PËR KËSHILLAT E NXËNËSVE



Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë doracak nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (Basic Education Program) të USAID-it të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

fhi360
THE SCIENCE OF IMPROVING LIVES

Basic Education Program

DORACAK PËR KËSHILLAT E NXËNËSVE

Për Anëtarët e Këshillave të Nxënësve

HARTUAR NGA

Merita Shala

DIZAJNI GRAFIK

indesign

BOTIMI I PARË

Maj, 2013

FALENDERIME:

Basic Education Program (Programi për Arsim Themelor) i USAID-it u shpreh falenderime të sinqerta të gjithë kontribuesve në realizimin e këtij doracaku. Falenderime të veçanta zyrtarëve për arsim të përgjithshëm në MASHT dhe fasilitatorëve të Programit për kontributin e dhënë në përpilimin e këtij doracaku.

Falenderim i veçantë po ashtu për anëtarët e këshillit të nxënësve nga "Shkolla e Gjelbër" dhe shkolla "Dardania" në Prishtinë për fotografitë e ofruara për këtë doracak.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	6
2. Disa fakte të rëndësishme	7
PJESA 1	8
Çfarë është ngacmimi dhe cilat janë sjelljet që e prezantojnë	9
Komponentët kryesorë të sjelljeve ngacmuese	11
Llojet e ngacmimeve	11
Efektet e ngacmimeve tek nxënësit	15
Të drejtat e fëmijëve	18
PJESA 2	19
Nxënësit kundër ngacmimeve	19
Çfarë duhet të bëni ju si këshill i nxënësve për të parandaluar ngacmimet ...	21
Çfarë mund të bëni kur ndodh ngacmimi	22
Disa materiale, libra për lexim të mëtejshëm	25

Hyrje

Materiali i dedikohet: Nxënësve, anëtarëve të Këshillave të Nxënësve të shkollave të mesme të ulëta, anëtarëve të komiteteve për të drejtat e fëmijëve në shkolla.

Rezultatet e pritshme: Me përvetësimin e këtij programi, nxënësit/et do të jenë të gjendje të:

- *Shpjegojnë nocionet ngacmim, presion, dhunë, agresion dhe llojet e shfaqjes së tyre*
- *Identifikojnë sjelljet përkatëse kur dhe nga kush ndodhin*
- *Analizojnë pasojat që kanë sjelljet përkatëse tek nxënësit që i pësojnë këto sjellje*
- *Përpilojnë planin e veprimeve përmes të cilit do të përpiqen të parandalojnë dhe të mbështesin shokët/shoqet e tyre që kanë pësuar ngacmim*
- *Tregojnë aftësi për punë ekipore*
- *Demostrojnë aftësi në trajtimin e situatave të ndryshme*
- *Demostrojnë qëndrime pozitive*

Përmbajtja:

1. Ngacmimi, sjelljet agresive, dhuna – hyrje në konceptet teorike dhe të drejtat e njeriut
2. Lloje të ngacmimeve dhe udhëzime për parandalimin dhe trajtimin e tyre
3. Një plan veprimi nga nxënësit për nxënësit: si mund të mbështesim shokët/shoqet në rastet e ngacmimeve dhe cilat janë veprimet e duhura të mundshme

Metoda e realizimit:

Programi do të karakterizohet nga aktivitete interaktive. Parashihet që pjesëmarrësve tu ofrohen disa koncepte teorike për çështjet përkatëse, të domosdoshme për zhvillimin e aktiviteteve praktike. Tema specifike do të shoqërohen me shembuj specifike dhe më pas pjesëmarrësit do të stimulohen të ndërmarrin veprime në mbështetje të nxënësve në trajtimin e rasteve. Karakteristikë është puna praktike në hartimin e një plani veprimi brenda shkollës nga nxënësit për nxënësit, plan i cili do të përfshijë hapat përkatëse, prej identifikimit të rasteve e deri në mundësimin e zgjidhjeve të tyre.

Shënim: Termi ngacmim është përdorur si sinonim i termit 'bullying'.

DISA FAKTE TË RËNDËSISHME!

- *Në shkallë të gjerë, sondazhet tregojnë që përqindjet e sjelljeve ngacmuese në shkolla janë në normat në mes të 3 dhe 27 për qind (Stassen Berger, 2007).*
- *Ngacmimet me qëllim lëndimi ndodhin nga të dy gjinitë pothuajse njëloj dhe të dy gjinitë janë të prirur për të pësuar ngacmime (Ziegler and Rosenstein-Manner, 1991; Charach e të tjerë, 1995).*
- *Ngacmimet ndodhin më shumë midis bashkëmoshatarëve të së njëjtës gjini.*
- *Nuk ndodhin ndërmjet dy nxënësve me forcë mendore dhe fizike pothuajse të njëjtë.*
- *Ngacmimi me fjalë lënduese është lloji më i zakonshëm i ngacmimit i raportuar, por 'ngacmimi elektronik', i cili zakonisht ndodh jashtë shkollës, po bëhet një çështje gjithnjë e më e rëndësishme.*
- *Djemtë kanë më shumë gjasa të jenë të përfshirë në ngacmimet fizike, ndërsa vajzat në ngacmimet verbale. (Pepler e të tjerë, 1997).*
- *Marrëdhëniet në familje dhe ndërmjet shokëve/shoqeve janë identifikuar si faktorë të rëndësishëm për ngacmimet qoftë për fëmijët që ngacmojnë apo për fëmijët që ngacmohen. Ngacmimi ka pasoja afatgjata negative për të gjitha grupet. (Slee, 1995; Craig, 1997).*
- *Ngacmimi është një proces në grup. Ngacmimi zakonisht ndodh në sy të fëmijëve të tjerë, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në ngjarje, kështu ngacmimi mund të jetë më shumë present në disa klasa apo nivele se të tjerët. (Atlas and Pepler, 1997; Craig and Pepler, 1997).*
- *Shumë viktime të ngacmimeve nuk i raportojnë këto ngacmime tek mësuesit/et, por në përvojën e atyre që e bëjnë, disa mund të ndihmojnë, ndërsa të tjerët nuk bëjnë asnjë ndryshim apo mund edhe ta përkeqësojnë situatën.*


PJESA 1:

- Çfarë është ngacmimi dhe cilat janë sjelljet që e prezantojnë?
- Cilat janë llojet e tij?
- Cilat janë efektet e ngacmimit tek nxënësit?
- Të drejtat e fëmijëve dhe ngacmimi.

Shfrytëzimi i kësaj pjese do t'ju ndihmojë të:

- **Parafrazoni çfarë është ngacmimi dhe cilat janë sjelljet që e prezantojnë atë**
- **Keni të qartë dhe të mund t'ua shpjegoni edhe të tjerëve nocionet ngacmim, dhunë, sjellje agresive.**
- **Identifikoni dhe përcaktoni sjelljet përkatëse, kur ndodhin, nga kush ndodhin dhe të përgatiteni për trajtimin e tyre**
- **Analizoni pasojat që kanë sjelljet e tilla tek nxënësit që i pësojnë këto sjellje**
- **Përmirësoni aftësitë tuaja përkitazi me zbatimin e të drejtave të nxënësve**

Çfarë është ngacmimi dhe cilat janë sjelljet që e prezantojnë?



Përkufizimi më i përdorur për ngacmimin, është nga Olweus (1987):

“Një person pëson ngacmim kur ai/ajo është i/e ekspozuar në mënyrë të përsëritur ndaj veprimeve dhe sjelljeve negative, lënduese nga një ose më shumë persona të tjerë”.

Veprime negative konsiderohen kur dikush me qëllim shkakton ose përpiqet të shkaktojë një lëndim ose paretat tek një person tjetër. Këto veprime mund të jenë verbale, p.sh. kërcënimi, degradimi, presioni, sharja por edhe jo verbale, pra fizike të tilla si goditja, gjuajtja, shtyrja, thyerja e sendeve personale, gjestet e shëmtuara apo shtrembërimet me qëllim të fytyrës, etj. Ngacmimi mund të ndodhë nga një person ose ndaj një personi, por gjithashtu mund të ndodhë edhe nga një grup personash ndaj një individi ose grupi personash.

Duhet theksuar se ky përkufizim specifikon që veprimet negative duhet të kryhen në mënyrë të përsëritur dhe me qëllim lëndimi që të konsiderohen ngacmim, dhe kjo përjashton veprimet e rastit. Në mënyrë që të konsiderohet ngacmim, duhet gjithashtu të ketë një çekuilibër ose perceptim të një disekuilibri forcash/fuqish. Nxënësit që përjetojnë veprimet negative kanë probleme në mbrojtjen e vetvetes dhe janë të pafuqishëm ose mendojnë se janë, në një farë mase kundër personit ose personave që i ngacmojnë.

Një dallim tjetër që duhet bërë në përcaktimin e ngacmimit, është ai midis ngacmimit të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. Ngacmimi i drejtpërdrejtë është definuar si sulm i hapur mbi të ngacmuarin (viktimën), ndërsa ngacmimi indirekt shprehet në izolimin shoqëror dhe përjashtimin nga grupi. Një tjetër kriter, është se ngacmimi nuk konsiderohet i tillë kur shkaktohet, provokohet nga i/e ngacmuari/a (viktima).

Mbani mend:

Shumica e fëmijëve/nxënësve në shkollë do të përjetojnë një herë ngacmimin, qoftë si të ngacmuar, ngacmues ose thjesht dëshmitar

Ngacmimi konsiderohet si lloji më i përhapur i sjelljeve agresive, i cili ndodh shpesh në shkolla. Si me llojet e tjera të sjelljeve agresive, dëmet që shkaktojnë - qoftë fizike apo emocionale, apo të dyja - janë të qëllimshme. Megjithatë, ngacmimi ka disa karakteristika të cilat e veçojnë atë nga sjelljet e tjera agresive. Një nga këto është që

është sjellje e përsëritur, dhe se individët që ngacmojnë janë më të fuqishëm, më me ndikim në shkollë se sa ata që ngacmohen.

Disa nga sjelljet më të zakonshme të ngacmimeve janë: të quajturit me nofka, duke thënë apo shkruar gjëra të këqia, duke i lënë shokët/shoqet jashtë aktiviteteve, duke i injoruar apo duke mos folur qëllimisht me ta, duke i kërcënuar, duke i bërë të ndihen të pakëndshëm ose të frikësuar, duke dëmtuar apo prishur gjërat e tyre, duke i goditur apo shkelmuar, ose duke i detyruar të bëjnë gjëra që ata nuk duan ti bëjnë.

Në këtë material, ngacmimi/bullingu, i referohet ngacmimeve me qëllim lëndimi fizik, ose/edhe emocional ose/edhe social ndërmjet bashkëmoshatarëve në shkolla.

Për të qenë më të qartë rreth sjelljeve lënduese, më poshtë janë dhënë sqarimet për domethënien e disa termave:

Ngacmimi / viktimizimi nga shokët, shoqet: në thelb buron nga dallimet në

forcën apo pushtetin e një individi dhe keqtrajtimin e këtij pushteti. Shpjegimet për ngacmimin mbështeten mbi teoritë sociologjike dhe i atribuohen kryesisht sjelljeve ngacmuese në marrëdhëniet shfrytëzuese ose të padrejta. Ngacmimet ndodhin kryesisht për shkak të dallimeve të bazuara në statusin socio-ekonomik, kulturor dhe gjuhësor, përkatësinë fetare, gjininë, seksualitetin dhe paaftësinë.



Dhuna: Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon dhunën si: Përdorim të qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim¹.



¹ World report on violence and health, Etienne G. Krug, Linda L. Dahlberg, James A. Mercy, Anthony B. Zwi and Rafael Lozano, World Health Organization, Geneva, 2002, f. 29

Sjellje agresive: ndodh kur ju konsideroni se të drejtat dhe besimet tuaja janë më të rëndësishme se të individëve të tjerë dhe ju i mbron ato në një mënyrë që shkel të drejtat e njerëzve të tjerë. Kjo ndodh duke thënë atë që ju besoni është e vërteta e vetme, dhe se çdo deklaratë kontradiktore është e gabuar.



Komponentët kryesorë të sjelljeve ngacmuese:

Literatura në përgjithësi sugjeron pesë komponentë kryesorë:

- **Qëllimi për të lënduar:** ngacmimi është i qëllimshëm, ai synon të shkaktojë lëndim, dëm. Kështu, miqtë që ngacmojnë njëri-tjetrin në një mënyrë babaxhane nuk është ngacmim, por një person që ngacmon një person tjetër me qëllim për ta mërztur atë, është ngacmim.
- **Rezultatet e dëmshme:** një ose më shumë persona janë të lënduar fizikisht apo emocionalisht.
- **Aktet, veprimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta:** ngacmimi mund të përfshijë agresion të drejtpërdrejtë, të tilla si goditjet por dhe aktet indirekte, të tilla si përhapja e thashethemeve.
- **Përsëritja:** ngacmimi përfshin akte të përsëritura: një akt i izoluar ngacmimi si një shtyrje apo sharje që ndodh vetëm një herë, nuk është bulling/ngacmim. (Megjithëse, mund të jetë edhe pikënisje)
- **Fuqia/pushteti e/i pabarabartë:** ngacmimi përfshin abuzimin e fuqisë/pushtetit nga një ose disa persona të cilët janë (perceptohen) më të fuqishëm, shpesh për shkak të moshës së tyre, forcës fizike, psikologjike ose gjindshmërisë.



Llojet e ngacmimeve:

Ngacmimet përfshijnë një mori të sjelljeve të natyrave të ndryshme. Këto sjellje përcaktojnë edhe llojet e ngacmimeve.

Ngacmimi fizik: përfshin çdo kontakt fizik që mund të lëndojë apo dëmtojë një person, të tilla si të qëlluarit me shuplakë, të shtyrit, të grushtuarit etj. Marrja e sendeve personale që i përkasin dikujt tjetër dhe shkatërrimi i tyre, po ashtu konsiderohet lloji apo sjellje e ngacmimit fizik.

Ngacmimi me fjalë/verbal: është të quajturit me ‘nofka’, duke bërë vërejtje ofenduese, ose ‘shaka’ në lidhje me aftësinë e një personi, gjininë, përkatësinë etnike, statusin socio-ekonomik, ose mënyrën se si duken. Për shembull, shakaja që i bëhet një nxënësi sepse ai nuk vrapon dot shpejt sikur fëmijët e tjerë, konsiderohet ngacmim verbal. Ngacmim verbal konsiderohet edhe kur përdoren fjalë kërcënuese kundrejt pronës personale të dikujt.

Ngacmimi indirekt: përfshin thashethemet e përhapura ose tregimet për dikë, duke iu treguarë të tjerëve diçka që është thënë juve në mënyrë private, dhe duke përjashtuar të tjerët nga grupet. Një shembull i ngacmimit indirekt, do të jetë nëse ju sajoni dhe përhapni një thashethem sikur një djali në klasën tuaj i pëlqen të luajë me kukulla, apo një vajzë luan futboll pasditeve dhe arsyeja që e bëni këtë, është sepse thjesht këto ju duken për të qeshur.

Largimi shoqëror: është kur dikush detyron, përjashton dikë nga një grup shoqëror, me qëllim. Largimi shoqëror gjithashtu përfshin përhapjen e thashethemeve, po ashtu edhe të tallurit me dikë duke vënë në pah ndryshimet e tij/saj.

Frikësimi: është kur një person detyron apo kërcënon dikë tjetër dhe e frikëson atë person mjaftueshëm për të bërë atë që personi detyruet dëshiron.

Ngacmimi elektronik/përmes teknologjisë: konsiderohet si një lloj i ri i ngacmimeve. Zhvillimi i teknologjisë, krijimi i rrjeteve të ndryshme sociale dhe aktiviteti i tepërt në to nga nxënësit, i ka ekspozuar ata edhe ndaj këtij lloji të ri të ngacmimit.

Ngacmimi elektronik/përmes teknologjisë përfshin përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të tilla si telefonat celular, kamerat, videot, e-maillet, dhe faqet web për të postuar ose dërguar mesazhe që ngacmojnë apo lëndojnë një person tjetër. Ekzistojnë shtatë kategori të ndryshme të ngacmimit elektronik/përmes teknologjisë:

Provokimi: Dërgimi i mesazheve të vrazhdëta, vulgare për një person në një grup online ose tek ai/ajo person përmes emailit.

Ngacmimi online: Dërgimi i vazhdueshëm i mesazheve ofenduese përmes emailit tek një person.

Biseda elektronike: ngacmime online që përfshijnë kërcënime të vazhdueshme tepër frikësuese.

Denigrimi: Dërgimi i deklaratave të pavërteta, të dëmshme, dashakeqe në lidhje me një person tek njerëzit e tjerë apo postimin online të materialeve të tilla.

Maskarada: të pretenduarit e të qenit dikush tjetër dhe dërgimi apo postimi i materialeve që e bëjnë atë person të duket keq.

Publikimi: Dërgimi apo postimi i materialeve në lidhje me një person që përmban informata të ndjeshme, private, apo të turpshme, duke përfshirë shpërndarjen e mesazheve private ose imazheve personale dhe private.

Përrjashtimi: përrjashtimi/largimi në mënyrë të vrazhdë i dikujt nga një grup në internet.

Por, ndërsa sjelljet ngacmuese mund të jenë të drejtpërdrejta (p.sh., duke goditur, shtyrë, quajtur me nofka, sharë, etj) ose përfshijnë një grup nxënësish që në mënyrë indirekte ngacmojnë një nxënës tjetër (p.sh., duke e përgojuar, duke e përrjashtuar, etj), ngacmimi elektronik/përmes teknologjisë, është një formë jo e drejtpërdrejtë e ngacmimeve, ku ata që ngacmojnë nuk ngacmojnë në një ndërveprim ballë për ballë, por përmes një ndërfaqe (ekran kompjuter, telefon). Por, nëse sjelljet ngacmuese në shkollë ndodhin në prani të nxënësve të tjerë, mesazhet apo materialet e postuara on-line janë nën një 'vështrim' akoma më të madh, akoma më publik dhe mund të shikohen edhe nga të njohurit edhe nga të huajt.

Ngacmimet mund të motivohen nga besimet paragjyquese ose qëndrimet ndaj përkatësisë etnike, fetare, kulturës, gjinisë, seksualitetit etj.

POR :

**ASKUSH NUK MERITON TE LENDOHET !
KA SHUME MENYRA PER TE NDALUR NGACMIMET**

AKTIVITET:

PROVONI TE HULUMTONI SA JANE PREZENT SJELLJET NGACMUESE NE KLASEN, SHKOLLEN TUAJ!

JINI TE SINQERTE!

Listë e sjelljeve ngacmuese				Sa shpesh ndodhin këto:		
Sjellje ngacmuese	...në klasën tuaj			...në shkollën tuaj		
	rrallë	ndonjëherë	shpesh	rrallë	ndonjëherë	shpesh
1. goditje						
2. shtyrje						
3. grushtim						
4. fyerje						
5. sharje						
6. prekje pa dëshirë						
7. kërcënim						
8. poshtërim						
9. vënie nofkash						
10. përqeshje						
11. nxjerrje e gjuhës						
12. gjeste të papëlqyeshme						
13. e folur me ironi						
14. injorim						
15. mënjanim						

Efektet e ngacmimeve tek nxënësit



Shumë njerëz mendojnë se ngacmimi është një pjesë normale e fëmijërisë, rritjes, apo se “fëmijët janë fëmijë”, ska problem që edhe ngacmojnë njëri-tjetrin. Por studimet tregojnë që në fakt, ngacmimet mund të shkaktojnë efekte mjaft negative në aspektin e arritshmerisë shkollore, fizik, social, emocional dhe psikologjik për ata që pësojnë këto sjellje, për ata që i kryejnë këto sjellje dhe ata që janë thjesht dëshmitarë të tyre. Këto pasoja mund të jetë afat-shkurtëra apo afat-gjata.

Suksesi në shkollë është aspekti i parë ku vërehet ndikimi nga ngacmimet në shkollë. Studimet e mbështesin fuqishëm lidhjen e ngushtë ndërmjet tyre. Për shkak që fëmijët që ngacmohen jetojnë me ndjenjën e frikës brenda vetes, me ndjenjën e fajit, me ndjesinë e të qenit i dobët cka edhe ndikon në tiparet e personalitetit dhe vetëvlerësimin e tyre, kjo situatë i bën ata të paafatë për të mësuar. Këtyre fëmijë iu bie dëshira të shkojnë në shkollë dhe kanë tendencë të mungesave pa arsye. Për më tepër, ata humbasin mundësitë e tyre për të marrë pjesë bashkë me të tjerët në aktivitetet shkollore. Për këtë arsye, ata fillojnë të kenë rënie në suksesin e tyre shkollore.

Përsa i përket shëndetit psikologjik të nxënësve, ata që kanë pësuar sjellje ngacmuese, janë më të ekspozuar ndaj çrregullimeve psikologjike si ankthi, depresioni, vetëvlerësim i ulët dhe vetmia. Të gjitha këto ndikojnë në reagimet e tyre ndaj vetvetes dhe të tjerëve. Përveç kësaj, nxënësit bëhen më të turpshëm si dhe kanë vështirësi të pranojnë vetveten pas ngacmimeve, çka i çon ata edhe drejt përjashtimit social.

Gjithashtu, hulumtimet kanë treguar se nxënësit të cilët janë keqtrajtuar në shkollë shfaqin edhe sjellje internalizuese, të tilla si ankthi, vetmia, trishtimi dhe pasiguri. Përveç këtyre sjelljeve nxënësit mund të shfaqin edhe sjellje externalizuese si impulsivitet dhe hiperaktivitet. Po ashtu disa studime mbi ngacmimin elektronik/teknologjik kanë dokumentuar që tek fëmijët që pësojnë ngacmimin, ka prezencë të sjelljeve që përfshijnë frustrimin, zemërimin, dhe pikëllimin.

NGACMIMET NDODHIN. MESO TI NDALOSH ATO!

**Ju mund të përforconi aftësitë tuaja
për tu përballuar me këto sjellje.**

Një strategji: 'Hi 5 - Cake këtu'

Secili gisht i dorës prezanton një përgjigje ndaj ngacmimit:

- 1. Injoroje - mos ia vër veshin**
- 2. Largohu - shmange**
- 3. Përgjigju sjellshëm**
- 4. Fol prerë**
- 5. Raporto**



Aktivite informimi:

Ju mund të gjeni më tepër informacion për ngacmimet në:

<http://www.bullyonline.org/workbully/bully.htm>

<http://www.education.com/topic/school-bullying-teasing/>

http://kidshealth.org/kid/grow/school_stuff/bullies.html

http://en.wikipedia.org/wiki/School_bullying

<http://www.teachsafeschools.org/bullying-prevention.html>

American Academy of Child and Adolescent Psychiatry

www.aacap.org

American Psychological Association

Bully fact sheets

www.apa.org/topics/topicbully.html

Antibullying Network

www.antibullying.net

Bullying

<http://www.talk-helps.com>

Bully Online

www.bullyonline.org

Canadian Initiative for the Prevention of Bullying

<http://www.cipb.ca>

Center for Disease Control and Prevention

<http://www.cdc.gov/HealthyYouth/>

www.bam.gov

Të drejtat e fëmijëve



Burimi: **act!onaid** (<http://www.actionaid.org/thailand/what-we-do/right-education>)

Ngacmimi dhe të Drejtat e Njeriut (Akti 1988)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk bën dallim në të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e rriturve. Të drejtat që ajo përmban janë të nevojshme që t'u akordohen çdo qenie njerëzore dhe të respektohen pa diskriminim.

Ngacmimi është një shkelje e shumë prej këtyre të drejtave.

**ËSHTË E DREJTA E ÇDO FËMIJE
TË MOS JETË I LËNDUAR**

DHE

**ËSHTË PËRGJEGJËSI E ÇDO FËMIJE
TË MOS LËNDOJË**

PJESA 2:

- Cilat mund të jenë disa nga mënyrat e reagimit ndaj sjelljeve të tilla
- Këshilla për të trajtuar ngacmimet
- Hapat që mund të ndërmerren për të parandaluar dhe vepruar ndaj sjelljeve të tilla

Kjo pjesë do t'ju ndihmojë ju të:

- **Përgatiteni për të parandaluar dhe trajtuar sjelljet ngacmuese**
- **Analizoni mundësitë për të ndihmuar shokët dhe shoqet që pësojnë ngacmime, që ngacmojnë apo edhe që janë thjesht dëshmitarë**
- **Mendoni më tej për çfarë mund të bëni dhe si**
- **Përforconi aftësitë tuaja për të vepruar më fort kundër ngacmimeve**

Nxënësit kundër ngacmimeve

Ngacmimi ndikon tek të gjithë, pavarësisht nëse ju jeni objekt i ngacmimeve, dëshmitar, ose personi që ngacmon, kjo është diçka që ndikon tek ju, bashkëmoshatarët tuaj, dhe shkollën tuaj. Ngacmimi mund të ndalet, por kjo nuk do të ndodhë vetëm. Ju jeni të inkurajuar të veproni siç duhet kur ndodh ngacmimi, ju mund të ndërmerri veprime pozitive. Veprimet e mundshme janë:

- **Bëhuni këmbëngulës, mbronni të drejtat tuaja. Thoni “më lër të qetë.”**
- **Mos u hakmerrni me sjellje agresive fizike ose verbale**
- **Injoroheni atë. Nëse ju tregoni që nuk jeni mërziur, ngacmimi mund të ndalet**
- **Qeshni me të, përdorni humorin**
- **Krijoni mbrojtjen tuaj duke bërë miq**
- **Bëhuni i/e zgjuar dhe shmangni vendet ku mund të ndodhë ngacmimi**
- **Flisni me të tjerët, mund t'ju ndihmojë të vendosni si ta përballoni apo trajtoni situatën ose ata mund të marrin masa, p.sh., shokët tuaj, nxënësit më të vjetër në shkollë, mësuesit, këshilltarët profesionalë, ose drejtori.**

Në përgjithësi literatura rekomandon që nxënësit kanë përgjegjësi:

- ***Të mësojnë më tepër për sjelljet lënduese dhe ti ndajnë këto informacione me shokët dhe shoqet***
- ***Të raportojnë çdo sjellje të tillë që ndodh në shkollë***
- ***Të mos hezitojnë të kërkojnë ndihmë***
- ***Të mos ngacmojnë***

Këshilla në qasjen anti-ngacmim, të ofruara për nxënësit që pësojnë ngacmim ose/ edhe për nxënësit që do ti mbështesin ata/ato:


- ***Përkrahni nxënësin/en sapo shihni që ndodh ngacmimi duke thënë “I lere të qetë atë”***
- ***Raportoje incidentin tek një mësuesimdhënës sa më shpejt që mundeni.***
- ***Bëj një raport, shënim anonim dhe vendose tek ‘kutia e ankesës’***
- ***Ofro mbështetje për djalnin/vajzën që ka pësuar ngacmim. Bëni sugjerime në lidhje me trajtimin e saj. Inkurajojeni atë të kërkojë ndihmë nga një i/e rritur (mësuesimdhënës, pedagogu, psikologu i shkollës etj).***

PARANDALIMI ËSHTË MË I LEHTË DHE MË I MIRË SE SHËRIMI

Studimet kanë treguar që sjelljet negative, lënduese në shkolla dhe rastet e ngacmimeve zvogëlohen kur organet e shkollës angazhohen në këtë drejtim (Charach e të tjerë, 1995)



Cfarë duhet të bëni ju si këshill i nxënësve për të parandaluar ngacmimet?



Si nxënës ju mund të kërkonti nga mësimdhënësit/et tuaj/a të lëndës së "Aftësive për jetën" për të organizuar një orë mësimore, në të cilën ju mund të bisedoni rreth:

Cfarë është ngacmimi? Cfarë duhet të dimë për të? Pse ndodh? Pse disa nxënës ngacmojnë? Cilët janë nxënësit që kanë prirje për të ngacmuar të tjerët? Si dhe pse ndikohemi nga njëri-tjetri? Cilat janë disa nga reagimet tona në situata ngacmimi? Si mund të jemi më këmbëngulës e të themi jo!

Ju mund të projektioni një poster për të përcjellë një mesazh anti-ngacmim dhe ta prezantoni në shkollë.

- Siguroheni që cdo shqetësim apo raste të ngacmimeve nga nxënësit të bëhen të ditura edhe për drejtorinë e shkollës dhe stafin që ofron këshillim profesional.
- Kërkonti nga drejtoria e shkollës dhe nga këshilli drejtues i shkollës që të hartojnë një rregullore të vecantë ose të përfshijnë në rregulloren e shkollës disa veprime anti-ngacmim
- Kërkonti nga kryetarët e klasave që të jenë më sycelët në rastet e ngacmimeve dhe ti raportojnë ato
- Mbani shënim rastet e ngacmimeve që ndodhin

- Mbani qëndrim ndaj shokëve/shoqeve tuaja që bëjnë sjellje me qëllim lëndimi, ose lavdëroni shokët/shoqet tuaja për sjellje korrekte dhe mbështetëse.
- Organizoni aktivitete me shokët/shoqet tuaja që stimulojnë bashkëpunimin dhe janë interesante.
- Organizoni ditën e shkollës kundër ngacmimeve.
- Në bashkëpunim me mësime të tuaja, ftoni ekspertë të fushave të ndryshme që të ofrojnë informacione më të qarta dhe të sakta rreth ngacmimeve dhe pasojave të tyre tek nxënësit.
- Me ndihmën e mësimeve, zhvilloni një hulumtim për të evidentuar llojet e sjelljeve lënduese që ndodhin më tepër në shkollën tuaj.

Cfarë mund të bëni kur ndodh ngacmimi?

Secili prej nxënësve e përjeton ngacmimin, qoftë si ngacmues, qoftë si i ngacmuar apo qoftë edhe si dëshmitar. Me siguri të plotë, në asnjë rast ju si nxënës nuk do të ndjeheni mirë.

Ky është momenti kur ju duhet të veproni, të ndërmerrni dicka për të zvogëluar sa më shumë ngacmimet etilla në klasën, shkollën tuaj.

Ju mund të krijoni Planin tuaj të Veprimit.

Si?

Hapat e mëposhtëm do t'ju ndihmojnë të zhvilloni një plan veprimi për të adresuar një situatë ngacmimi që po ndodh me ju apo me dikë tjetër.

Hapi 1: Mendoni për ngacmimet që ju keni përjetuar, parë, ose edhe keni bërë vetë. Përshkruani situatën, duke përfshirë edhe ku ndodhi, kush ishte i përfshirë, çfarë ka ndodhur, dhe se si ju bëri të ndjeheni. **Identifikoni llojin e ngacmimit**

Hapi 2: Pastaj konsideroni se si situata mund të ndryshohet. Përfshini atë që ju do të veproni, se si gjërat mund të ndryshojnë. **Përcaktoni cilat janë stragjite dhe hapat e nevojshme që duhen bërë**

Hapi 3: Pastaj, mendoni se në hapat e nevojshme që duhen bërë, **çfarë roli keni, kush do të duhet të jenë të përfshirë, dhe atë që ata do të duhet të bëjnë.**

Hapi 1. Identifiko llojin e ngacmimit	Hapi 2. Përcakto cilat janë stragjite dhe hapat e nevojshme që duhen bërë	Hapi 3. Mendoni se çfarë roli keni, kush do të duhet të jenë të përfshirë, dhe atë që ata do të duhet të bëjnë
Situata 1:		
Situata 2:		

AKTIVITET KREATIV...

Ju mund të krijoni Planin tuaj Origjinal të Punës.

Diskutojeni këtë me bashkëmoshatarët tuaj dhe vendosni çfarë plani pune do të përgatisni.

KËSHILLA PRAKTIKE

- Jo të gjitha ngacmimet janë të dukshme, kështu që në shkollë mund të ketë më tepër ngacmime se sa që ju i shihni.
- Ngacmimet ndodhin më së tepërmi në klasat e larta (7,8,9) dhe gjatë kalimit në shkollën e mesme
- Nxënësit mund të veprojnë për të ndaluar ngacmimet, duke mbrojtur nxënësit që pësojnë ngacmim, duke krijuar grupe shoqërore me interesa mësimore të përbashkëta.
- Nxënësit që pësojnë ngacmime mund të kenë nevojë afatgjatë për mbështetje nga shkolla e tyre. Ju si anëtarë të këshillit të nxënësve keni rolin tuaj në këtë.
- Jini model me sjelljen tuaj, mos ngacmoni, kështu që bashkëmoshatarët tuaj do t'ju 'ndjekin' dhe do të ketë më pak sjellje ngacmuese në shkollë.
- Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të kenë një ambient shkollor të sigurt e mbështetës. Kontributi juaj në këtë është shumë i madh.

Disa materiale, libra për lexim të mëtejme:

Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri:

http://www.psikologjia.com/pdf/Dhuna_ndaj_femijeve_ne_Shqiperi.pdf

(Shtator 2012)

Raport nga hulumtimi i shpejtë i vlerësimit të gjendjes së të drejtave të fëmijës si dhe të gjendjes së sigurisë në shkollat e Kosovës:

http://www.kec-ks.org/document's/Raport_Vleresimi%20i%20TDF%20dhe%20sigurise%20ne%20shkolla.pdf

Olweus, D. (1993). *Bullying at school*. Cambridge: Blackwell

McGrath, H and Noble, T. (Eds) (2005) *Bullying Solutions* Sydney: Pearsons Education.

Rigby, K. (1996,) *Bullying in Schools - and what to do about it*. Melbourne: ACER

Rigby, K. (2003) *Addressing bullying in schools: Theory and Practice, Trends and Issues*, Australian Institute of Criminology, 1 – 6. Download

<http://www.aic.gov.au/publications/tandi2/tandi259.html>

Rigby, K (2004) *Bullying: What can we do ? A paper for the NSW Commission for children and young people*. Download from

http://www.kids.nsw.gov.au/files/seminar_bullyin

